

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“CT Systems” SH.P.K.

Sot, më date **17/10/2022**, Ne te nënshkruarit:

- **Eriol Pole** lindur ne Harunas, Gramsh me 09/07/1990, shtetas Shqiptar, rezident ne Tirane , mbajtes i leternjoftimit Nr.033343804, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “CT Systems” **SH.P.K.**. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

- **Seldir Isa** lindur ne Erseke me 01/04/1982, shtetas Shqiptar, rezident ne Tirane , mbajtes i leternjoftimit Nr. 034227815 , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “CT Systems” **SH.P.K.**. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: **“CT Systems” SH.P.K**

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën : Rruga e Kavajes, Njesia Administrative Nr.6, Zona Kadastrale Nr. 8240, Apartamenti Nr.5, Kati i VII, Shkalla 2, Tirane, 1027.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: ctsystemshpk@gmail.com
Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

- Projektimi, realizimi, menaxhimi dhe kontrolli i sistemeve informatike dhe te programeve aplikative, si dhe ushtrimi i aktivitetit informatik dhe telematik te kryer ne favor te te treteve, perpunimin e te dhenave per te tretet, realizimin e shitjes se produkteve editorial. Aktivitet te tregtimit. Si me pakice ashtu edhe me shumice, me korrispondence dhe me rruge telematike, te produkteve dhe sherbimeve per shoqeri tregtare, per profesioniste dhe persona private, per automatizimin e zyres dhe ne pergjithesi per informatizimin e te dhenave, si dhe te aparaturave. Ndertim zhvillim sistemi (programi) per menaxhim te dhenash te klasifikuara dhe te paklasifikuara per instutucione shteterore dhe jo shteterore vendase dhe te huaja si dhe per OKB, NATO, BE dhe organizata te tjera nderkombetare. Krijim faqe internet per subjekte te ndryshme vendase dhe te huaja. Pergatitje programesh software per telefon, kompjuter dhe web. Marketing online. Mirembajtje programe kompjuterike dhe faqe internet per subjekte shteterore dhe jo shteterore vendase dhe te huaja si dhe per OKB, NATO, BE dhe organizata te tjera nderkombetare. Zhvillim software, hardware instalime dhe adoptime te ndryshme. Instalim dhe montim serverash, mbeshtetje teknike per subjekte te tjera. Veprimtari te ndryshme ne teknologjine informative dhe sherbime kompjuterike. Edukime (trajnime) ne lidhje me programet kompjuterike, perdorimin e tyre si teknologjine informative. Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet te lejuar nga ligji duke perfshire edhe fusha te vecanta te aktivitetit qe lidhen me marrjen e licencave apo pjesemarrje ne urdhra apo grupime profesionale.
- Megjitheate shoqeria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **300.000** (treqind mije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Eriol Pole**: Zotërues i 51% (pesëdhjetë e një përqind) te kuotave me vlerë të përgjithshme prej **153 000** (njqind e pesedhjetë e tre mije) Leke që përbën **51 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Seldir Isa**: Zotërues i 49% (dyzet e nente përqind) te kuotave me vlerë të përgjithshme prej **147 000** (njqind e dyzet e shtatë mije) Leke që përbën **49 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para .



Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortaket jane te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- f) kontributit në kapitalin e shoqërise
- g) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- h) trashëgimise;
- i) dhurimit;
- j) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve, përse nuk parashikohet ndryshe në statur. Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqerisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqerise.

Neni 9

Administrimi



Aministrator i shoqërisë emerohet **Z. Eriol Pole** lindur ne Harunas, Gramsh me 09/07/1990, shtetas shqiptar , mbajtes i leternjoftimit Nr. 033343804 , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar., i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësité e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përbastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë jane te percaktuara ne statuin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Eriol Pole

Eriol Pole

Seldir Isa

Seldir Isa